


PARANDALIMI I KONFLIKTIT TE INTERESAVE NE USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE



Pergatiti: Fjorida KALLÇO

www.hidaa.gov.al





Kuadri ligjor i konfliktit te interesave


- ❑ **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**
- ❑ **Kodi i Procedurave Administrative**
- ❑ **Ligji nr.9131, datë 8.9.2003** “Për rregullat e etikës në administratën publike”
- ❑ **Ligji nr.9367, datë 7.4.2005** “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (PKI).
 - *Ligji PKI Instrument i rëndësishëm ligjor në luftën kundër korrupsionit.*
 - *Ligji synon, të standardizojë dhe unifikojë të gjitha rregullat për të gjitha format e konfliktit të interesave dhe për të gjithë kategoritë e zyrtarëve publikë ku përfshihen: të zgjedhur, anëtarët e qeverisë, drejtuesit e institucioneve të pavaruara, nëpunësit publikë, gjyqtarët dhe prokurorët.*
 - *Ligji mbulon të gjitha proceset vendimmarrëse publike: legjislative; administrative (të pushtetit qendror dhe vendor); gjyqësore (civil, penal e administrativ).*



Ligji i parandalimit te konfliktit te interesave

Ky ligj percakton:

- Nje qellim te qarte, te lidhur me vendimmarrje te paanshme, transparente, ne interesin e publikut dhe forcimit te besimit te tyre ne institucionet publike,
- Strukturën institucionale përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji duke ndjekur parimin e krijimit të një strukture qendrore (ILDKP);
- Detyrime, standarte dhe procedura për deklarimin e interesave private;
- Ndalime dhe kufizime te interesave private të zyrtarëve për parandalimin e rasteve të veçanta të konfliktit të interesave;
- Ndalime dhe kufizime te interesave private për rastet e papajtueshmerise me funksionin publik per kategori te caktuara zyrtarësh
- Mjete dhe metoda alternative të përdorshme në çdo situatë dhe nga çdo institucion, për mënyrën e zgjidhjes së një momenti me konflikt interesi;
- Pasojat e akteve te marra ne kushtet e konfliktit te interesave
- Sanksione për shkeljet ligjore, gjate ushtrimit te funksioneve publike






Roli i ILDKP ne evidentimin e parandalimin e K.I

Inspektorati i Lartë, me cilësinë e autoritetit qendror përgjegjës për zbatimin e ligjit PKI, kryen detyrat dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- ✧ ofrimin e asistencës teknike për këshillimin dhe mbështetjen e nismave ligjore dhe nënligjore, të ndërmarra nga institucionet publike, për parandalimin e konfliktit të interesave;
- ✧ forcimin e kapaciteteve për administrimin e konfliktit të interesave në institucionet publike;
- ✧ këshillimin e zyrtarëve të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave;
- ✧ verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit rast për rast të interesave, si dhe të ndalimeve e kufizimeve të interesave të përcaktuar në ligji, me kërkesë të institucionit publik a epror ose kur e gjykon të nevojshme edhe me nismën e tij;
- ✧ vendosjen e masave administrative ndëshkuese në kompetencë të tij, sipas përcaktimeve në këtë ligj;






Sistemi i identifikimit te konfliktit te interesave

1. Sistemi i identifikimit te interesave ne kushtet e konflikteve rast per rast te interesave private.

2. Sistemi i identifikimit periodik te interesave private, nepermjet kontrollit qe ILDKP ushtron periodikisht mbi deklaratat e interesave private te zyrtareve deklarues.

Sistemet, rast për rast dhe periodike, të identifikimit e të regjistrimit të interesave ndihmojnë ne:

- parandalimin sa më të frytshëm të konfliktit të interesave;
- mundësinë për informim sa më të plotë e më të lehtë të publikut me të dhënat e regjistruara të interesave.






Hetimi i rasteve te Konfliktit te interesave

- ❖ **Hetimi administrativ i Konfliktit te Vazhdueshem te interesave - papajtueshmerise ndermjet detyres publike dhe interesave private te zyrtarit.**
 - Kontrolli aritmetik e logjik
 - Kontrolli i plote
- ❖ **Hetimi administrativ i Konfliktit te Interesave ne vendimarrje te veçanta rast pas rasti, kryesisht për**
 - Akte administrative te institucioneve qendrore dhe vendore
 - Kontrata me pale një institucion publik,
 - Prokurime publike, Ankande, Konkensione, etj

Inspektorati i Larte, fillon procedurat e hetimit adminisitrativ per konflikt interesi, me kerkese te intitucionit epror ose dhe nismen e tij, kur vihet ne dijeni nga burime te ligjshme.





Burimet e identifikimit të interesave private

Identifikimi nga persona të tretë

❖ **Detyrë për:**

- ⇒ Çdo zyrtar tjetër që ka dijani, në veçanti e eprorit;
- ⇒ Çdo institucion publik, që ka dijani.

❖ **E drejtë për:**

- ⇒ Palët e interesuara që preken nga veprimet e zyrtarit;
- ⇒ E çdo personi, që ka dijani dhe interes në përgjithësi.

❖ **Burime të tjera informacioni**


- regjistrat publikë ose privatë;
- të dhënat nga media;
- të dhënat ose ankesat nga publiku;
- çdo burim tjetër i ligjshëm.
- denoncime në numrin pa pagesë 0800 9999 te ILDKP
- shkresa zyrtare dhe posta elektronike unedenoncoj@hidaa.gov.al



Mbrojtja per dhenien e informacionit

Çdo zyrtar apo çdo subjekt, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga subjektet e këtij ligji, përfiton, sipas rastit, një mbrojtje të veçantë administrative:

- zyrtari, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi subjektin informues dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
- kur marrja e masës ndaj subjektit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.






Kufizimet për konfliktin rast për rast të interesit

Ligji PKI ka percaktuar kufizime te interesave private per parandalimin e konfliktit rast per rast te interesit per çeshtje te veçanta qe lidhen me:

- Ndalimin e lidhjes se kontratave
- Të ardhurat për shkak të funksionit
- Dhuratat, favoret, premtimet dhe trajtimet preferenciale


Ligji ka parashikuar kufizime dhe për personat e lidhur me zyrtarin: Bashkeshorti/ja, femijet ne moshe madhore dhe prinderit e zyrtarit dhe te bashkeshortit/es.





Kategorite e perfshira ne ndalimin e lidhjes se kontratave

- Presidenti i Republikes;
- Kryeministri, zëvendës-kryeministri, ministrat e zëvendës-ministrat;
- Deputetët;
- Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese e të Gjykatës së Lartë; anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), Avokati i Popullit, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive (ILDKP); Anetaret e organeve te autoriteteve rregullatore;
- Sekretarët e Përgjithshëm, drejtorët e departamenteve e drejtorët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është, të paktën, i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm.





Ndalimi absolut i lidhjes se kontratave (Neni 21.1)

- ❖ Ligji ka percaktuar ndalimin per zyrtaret dhe personat e lidhur me ta, ne lidhjen e kontratave me pale nje institucion publik per shkak te funksionit publik,pergjegjesive e kompetencave te tyre.
- ❖ Zyrtaret e perfshire ne ndalim, nuk mund te perfitojne fonde publike te prokuruar nga asnje institucion publik qendror apo vendor, ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.
- ❖ Ndalimi absolut shtrihet ne te gjitha llojet e kontratave si: Prokurimi publik i ndertimeve, mallrave apo sherbimeve, shitja, shkembimi, qiraja/emfiteoza, dhurimi, furnizimi, sipermarrja, transporti etj, *(pervec kontratave te parashikuara ne nenin 21/5).*

ILDKP ka ne proces realizimin e kontrollit elektronik për identifikimin e rasteve të konfliktit faktik të interesave të zyrtarëve në prokurimet e fondeve publike, ankandet dhe koncensionet.





Kufizimet për Konfliktin e vazhdueshëm të interesit

Ndalimet dhe/ose kufizimet shtrihen në kategori të caktuara të zyrtarëve dhe janë të diferencuara sipas rëndësisë e peshës së funksionit të tyre, si dhe riskut të rënies në KI. Ata pëfshijnë kategoritë e mëposhtme të zyrtarëve:

- Anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe Zëvendësministrat Deputetët,
- Kryetarët e bashkive/komunave/këshillave të qarqeve,
- Anëtarët e enteve rregullatore,
- Zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues në adm. publike, policinë e shtetit dhe forcat e armatosura,
- Zyrtarët e organit doganor dhe tatimor,
- Funksione të larta shtetërore,
- Personat e lidhur me zyrtarin (Bashkeshorti/ja dhe prinderit reciproke, femijet në mosha madhore.)




Kufizimet për Konfliktin e vazhdueshëm të interesit

Ndalimet ose kufizimet e interesave private të parashikuara në ligj, përqendrohen kryesisht në dy drejtime kryesore:

1. Ndalime në ushtrimin e veprimtarive private dhe angazhimin në organizata

- Si drejtues në org. fitimprurëse ose jofitimprurëse
- Ushtrim veprimtarie si person fizik, ortakëri, profesion i lirë etj
- Punësim me kohë të plote në detyra tjeter

2. Kufizime të diferencuara në zotërimin e aksioneve ose të pjesëve në kapital bazuar në vlerësimin e lidhjes me funksionit dhe riskut/dëmit të mundshëm nga konflikti i interesit.





Menyrat baze te trajtimit dhe zgjidhjes se K.I.

Zyrtari ne ushtrimin e funksioneve publike ka detyrimin te zgjidhe vete cdo suate te K.I, duke perdorur nje ose disa nga menytrat:

- Transferim ose tjetersim i interesave private
- Vetperjashtim nga procesi konkret i vendimmarrjes
- Doreheqje nga angazhimet, detyrat private
- Doreheqje nga funksioni publik
- Njoftimi i eprorit dhe provimi e dokumentimi i zgjidhjes së KI

Zyrtari nuk clirohet nga pergjegjesia e renies ne konflikt interesi, kur masat e marra nga vet ai nuk rezultojne te frytshme ne parandalimin dhe shmangjen e K.I.






Menyrat baze te trajtimit dhe zgjidhjes se K.I.

Eprori i zyrtarit ka detyrimin ligjor te parandaloje rastet te konfliktit te intereseve mes zyrtareve te institucionit qe ai drejton, duke perdorur nje ose disa nga menyrat e meposhtme:


- **Ndaj zyrtarit**
 - » Kufizim i informacionit
 - » Mosngarkimi i detyrave
 - » Perjashtim nga vendimmarrja
 - » Rishikimi ose ndryshimi i detyrave/kompetencave
 - » Transferim i zyrtarit ne detyre tjeter
 - » Shmangia e emerimit,zgjedhjes
- **Ndaj aktit (vendimmarrjes te marre ne kushtet e konfliktit te interesave per shkak te interesave private te zyrtarit)**
 - » Anulim/revokim i aktit ne K.I.





Pavlefshmeria e akteve dhe kontratave


- ❖ Pavlefshmëria relative e akteve dhe kontratave administrative të nxjerra në konflikt faktik interesi;
- ❖ Moskrijimi i pasojave juridike (pavlefshmeria absolute) për kontratat civile;
- ❖ Rishikimi dhe rrëzimi i akteve të organeve gjyqësore, noteriale, të organeve të përmbarimit dhe të organeve të prokurorisë;
- ❖ Pavlefshmeria relative e akteve normative dhe dispozitave me karakter individual e me pasoja juridike për subjekte individualisht të përcaktuara në ligje (përfshirë ligjet e zakonshme) të nxjerrë në konflikt faktik interesi.





Sanksionet per shkelje te ligjit per parandalimin e Konfliktit te interesave


- 1. Për shkelje të dispozitave të ligjit PKI, parashikohet vendosja e masave administrative gjore ndaj zyrtareve pergjegjes, të cilat jepen nga Inspektori i Përgjithshëm**
 - 10 000- 100 000 lekë, per shkelje te ndalimeve ne lidhjen e kontratave, sigurimin e ta ardhurave per shkak te funksionit, marrjes se dhuratave, favoreve, trajtimeve preferenciale nga ana e zyrtarve.
 - 100.000 – 200.000 leke, per shkelje te afateve dhe procedurave ne zgjidhjen e konfliktit te vazhdueshem te interesave
 - 200.000 - 400.000 leke, ne rastet kur per shkak te konfliktit te interesave, akti behet i pavlefshem





Sanksionet per shkelje te ligjit per parandalimin e Konfliktit te interesave

2. **Masa disiplinore**, pavarësisht nga përgjegjësia penale ose administrative.
3. **Ndjekje penale** kur shkelja e kryer nga zyrtari përben elemente te vepres penale i K.Penal- .
 - Shperdorimi i detyres -Neni 248
 - Perfitimi i paligjshem i interesave -Neni 257
 - Shkelja e barazise se pjesemarresve ne tendera- Neni 258
 - Korrupsioni pasiv i personave qe ushtrojne funksione publike- Neni 259
 - Korrupsioni aktiv i personave qe ushtrojne funksione publike- Neni 260
4. **Kalimi i barres se demshperblimit** zyrtarit qe ka vepruar me keqbesim. Masa e demshperblimit perfshin:
 - Demet pasurore
 - Demet jopasurore
 - Fitimin e munguar





Te dhena mbi veprimtarine e ILDKP per vitin 2010

- **ILDKP, ka shqyrtuar 261 raste te konfliktit te interesave,**
 - **195 raste** janë evidentuar nga informacionet e mbërritura prej Autoriteteve Përgjegjëse të institucioneve publike dhe pale te interesuara; nga informacionet e mbërritura në mënyra të ndryshme komunikimi (postë, e-mail, telefonata, etj.); dhe nga media.
 - **66 raste** te evidentuara nga Kontrolli Aritmetiko-Logjik i kryer mbi deklaratat e interesave private të subjekteve qe mbartin detyrimin per deklarim te interesave private në ILDKP;
- **Masa administrative gjobe,** ndaj **20 zyrtareve** te nivelit te larte drejtues jane marre, per moszgjidhje ne kohen dhe menyren e duhur ligjore konfliktin e interesave.
- Hartuar dhe zbatuar strategji ndërgjegjësuere dhe kontrolluese, duke u fokusuar në parandalimin në kohë të konfliktit të interesave në vendimmarrjet publike.
- Ne kuader te forcimit te kapaciteteve per administrimin e konfliktit te interesave ne institucionet publike jane organizuar trajnime me
 - **480 zyrtare** te niveleve te ndryshme te institucioneve qendrore
 - **110 zyrtare** te administrates se Bashkive dhe Keshillave Bashkiake

FALEMINDERIT PER VEMENDJEN



Pergatiti: **Fjorida KALLÇO**

www.hidaa.gov.al

20